



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 484/1 Prot.

Tiranë, më 5 / 4 /2018

V E N D I M

Nr. 94 , Datë 5 / 4 /2018

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 114, datë 22.08.2017, të paraqitur nga subjekti ankues E.M, kundër A.L në cilësinë e Administratorit të Ujësjetës Mat sh.a, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “bindjes politike”<sup>1</sup>, “gjendjes arsimore” dhe “çdo shkak tjetër”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

Sipas shpjegimeve të dhëna, në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash deklaroi se: *“Me Vendimin nr.9, datë 28.03.2013 të administratorit P.S është emëruar në detyrën si Kryetar i Degës Ekonomike pranë shoqërisë Ujësjetës Mat sh.a. Me Vendimin 34, datë 16.08.2016 të Administratorit A.L, është liruar nga detyra e Kryetarit të Degës Ekonomike të Ujësjetës Mat sh.a dhe është emëruar specialist finance, vendim të cilin e ka kundërshtuar pranë shoqërisë Ujësjetës Mat, por që nuk ka marrë përgjigje. Në lidhje me trajtimin e pabarabartë, E.M informon se në një rast të ngjashëm dhe NM me detyrë Kryetar i Degës Teknike pranë U.K Mat sh.a është ulur në detyrë dhe ka bërë ankesë për ndryshimin e pozicionit dhe i është marrë parasysh ankesa duke anuluar vendimin e mëparshëm. E.M pretendon se është diskriminuar për shkak të bindjes politike, pasi është anëtar i subjektit politik: Partia Socialiste e Shqipërisë”.*

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që të vërtetohet diskriminimi për shkak të gjendjes arsimore dhe bindjes politike.

Bazuar në nenin 33/4 të ligjit Nr. 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ankesa e paraqitur nga subjekti ankues, E.M, është e vlefshme nga pikëpamja formale pasi nuk ekziston

<sup>1</sup> Referuar kartës së anëtarësisë nr. 1/220, datë 26.04.2013, EM, anëtar i subjektit politik “Partia Socialiste e Shqipërisë” të rrethit Mat.

asnjë nga rastet përjashtuese të parashikuara në këtë nen, që do ta bënte këtë ankesë të papranueshme. Si pasojë ankesa iu nënshtrua shqyrtimit të plotë.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

- Me shkresën Nr. 832/1, datë 28.08.2017 është bërë njoftimi dhe i është kërkuar informacion subjektivit, Administratorit të “Ujësjellës Mat sh.a”, në lidhje me ankesën për pretendimin për diskriminim të paraqitur nga E.M.

Me shkresën Nr. 442, datë 11.09.2017 të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ujësjellës Mat, sh.a, ka kthyer përgjigje, pa e shoqëruar me gjithë dokumentacionin provues dhe në mes të tjerash ka informuar se: *“Që në fillim të emërimit të administratorit të ri AL, E.M nuk ka pranuar të bashkëpunojë, duke refuzuar e moszbatuar urdhrat e nxjerra nga ana e administratorit dhe për këtë fakt është marrë masë disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për zgjidhje të kontratës së punës”.* Në përfundim të ristrukturimit të

shoqërisë E.M iu caktua pozicioni i Specialistit të Financës, pozicion i përcaktuar me arsim të lartë. Tabela e pagave në shoqërinë e Ujësjetllës Kanalizimit Mat, janë të përcaktuara në bazë të vendimit për pagën minimale dhe vështirësive të punës sipas pozicionit. Në asnjë rast në shoqërinë Ujësjetllës Kanalizimit Mat nuk ka punonjës pa arsimin përkatës dhe jo me arsim 8-vjeçar dhe raste përveç specifikave në punë që një punonjës me arsim të mesëm të ketë pagë më të lartë se një punonjës me arsim të lartë. E.M, megjithëse ka ankimuar vendimin në rrugë administrative dhe jo gjyqësore ka vazhduar marrëdhënien e punës, ku ka punuar duke u paguar me pagën mujore të përcaktuar në vendimin e Këshillit Administrativ. E.M ka qëndruar në punë pa paraqitur asnjë pretendim për diskriminim dhe nuk është larguar nga puna nga ana e shoqërisë, por pas sigurimit të një pozicioni punë në një institucion tjetër ka dhënë dorëheqjen”.

Në lidhje me pretendimin e E.M për rastin e .M, shoqëria Ujësjetllës Mat sh.a, sqaron se, .M është me profesionin inxhinier dhe njëkohësisht Drejtues Teknik i licencuar i shoqërisë dhe pozicioni i caktuar si Përgjegjës i Kanalizimeve nuk përputhet me pozicionin e tij dhe u kthye në pozicionin e Drejtorit Teknik të shoqërisë.

Me shkresën të administruar pranë Komisionerit me Nr. 832/3, datë 20.09.2017, në mes të tjerash E.M informon se, me shkresën nr.606, datë 19.07.2016 ka kundërshtuar në rrugë administrative dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për zgjidhje të kontratës së punës” nga ana e shoqërisë, duke dërguar dhe observacionet përkatëse mbi refuzimin e urdhrit të administratorit të shoqërisë por që nuk ka marrë përgjigje.

**Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës dhe bazuar në dokumentacionin e administruar, Komisioneri vëren se:**

**I. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pretenduar nga ankuesi, për ndryshimin e pozicionit të punës me një pagë më të ulët, Komisioneri ka vërejtur se:**

Ankuesi E.M është punësuar pranë Ujësjetllës Mat sh.a, me datën 01.04.2013, me Vendimin e Administratorit, P.S Nr.9, datë 28.03.2013 në pozicionin “Kryetar i Degës Ekonomike”.

Me Vendimin nr.63, datë 27.01.2016 të Këshillit të Ministrave, është vendosur për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura në Republikën e Shqipërisë, sipas ndarjes së re administrativo-territoriale, në përputhje me ligjin nr.115/2014, “Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, duke ju transferuar bashkive të gjitha aksionet e shoqërive të ujësjetllës-kanalizimeve sh.a.

Me Vendimin nr.162, datë 12.04.2016 të Kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë Ujësjetllës Mat, N.R është vendosur shkarkimi i P.S si Administrator i shoqërisë dhe me Vendimin nr.164, datë 12.04.2016 është vendosur emërimi i A.L në detyrën e Administratorit të shoqërisë Ujësjetllës Mat sh.a.

Me Vendimin nr. 27, datë 14.07.2016 administratori i shoqërisë Ujësjetllës Mat sh.a, A.L ka vendosur dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për zgjidhje të kontratës së punës” për E.M me motivacionin “Thyerje të rëndë të disiplinës në punë”, për moszbatim të Urdhrit të Administratorit të Shoqërisë nr.23 dhe 24, datë 05.05.2016 “Për marrje në dorëzim të zyrës së administratorit” dhe “Për dorëzimin e inventarit të zyrës së administratorit”, vërejtje e cila është kundërshtuar nga ankuesi me shkresën nr.606, datë 19.07.2016, duke kërkuar revokimin e vendimit të administratorit të shoqërisë, ankesë e cila nuk ka marrë përgjigje.

Me Vendimin nr.34, datë 16.08.2016, E.M është njoftuar për lirimin e tij nga detyra e K/Degës Ekonomike dhe emërimin e tij në pozicionin si Specialist Finance për shkak të ristrukturimit të shoqërisë “Ujësjetllës Mat” sh.a dhe në zbatim të Vendimit nr.3, datë 07.07.2016 të Këshillit të Administrimit të Shoqërisë “Struktura Organizative dhe Struktura e Pagave të Ujësjetllës Mat sh.a”. Me shkresën nr.751, datë 17.08.2016 drejtuar A.L, administrator i shoqërisë, E.M e ka kundërshtuar vendimin e mësipërm me arsyetimin se nuk ishte njoftuar sipas parashikimeve të kontratës si dhe paga e ofruar për vendin e specialistit të financës prej 30.000 lekësh ishte e ulët dhe diskriminuese krahasuar me të njëjtin pozicion pune në institucionet e tjera si në Rrethin e Matit ashtu dhe në Bashkinë Mat, ankesë e cila nuk ka marrë përgjigje nga ana e administratorit të shoqërisë.

Nga parashtrimi i fakteve dhe shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga palët, vleresohet se:

- Në strukturën dhe nivelin e pagave të shoqërisë “Ujësjetllës Mat sh.a” të miratuar me Vendimin nr.14, datë 27.12.2013 të Këshillit Mbikëqyrës, është parashikuar zyra e Degës Ekonomike me 3 punonjës në pozicionet: K/Degës Ekonomike me arsim të lartë me pagë 53.400 lek, Llogaritar/Arkëtar/Operator me arsim të mesëm profesional me pagë 30.400 lek dhe magazinier me arsim të mesëm me pagë 27.000 lek.
- Në strukturën dhe nivelin e pagave të shoqërisë “Ujësjetllës Mat sh.a” me nr.560, datë 07.07.2016, është parashikuar: Drejtor Tregtor, 1 punonjës me arsim të lartë dhe mbi 5 vjet përvojë punë, Sektori i Financës me 3 punonjës në pozicionet: Shef Finance me arsim të lartë, me mbi 5 vjet përvojë punë, me pagë 53.000 lek, Specialist Finance me arsim të lartë, me mbi 5 vjet përvojë punë, me pagë 30.000 lek dhe magazinier me arsim të mesëm, me mbi 10 vjet përvojë punë, me pagë 28.000 lek.

Nga vlerësimi i dokumenteve të mësipërme, rezulton se hartimi i strukturës së re dhe nivelit të pagave është kryer në zbatim të Kreut 1, neni 2 të VKM nr.63, datë 27.01.2016.

Komisioneri vlerëson se, duke patur në vëmendje se rëndimi i situatës së ankuesit përkon në kohë me emërimin e A.L, dhe mosmarrëveshjet e lindura nga ky i fundit me E.M në lidhje me dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për zgjidhje të kontratës së punës” dhe më vonë emërimi i z.Meta në pozicionin e Specialistit të Financës dhe jo në pozicionin Shef i Sektorit të Financë, ngre dyshimin e arsyeshëm se të gjitha lëvizjet e mësipërme janë bërë në dëm të

subjektit ankues, duke përkeqësuar situatën e tij profesionale dhe financiare për shkak të bindjes së tij politike.

Po ashtu, emërimin në detyrën e specialistit të E.M, shoqëria “Ujësjetllës Mat sh.a” e ka argumentuar me faktin se meqënëse ankuesi nuk e ka kundërshtuar në rrugë ligjore vendimin e ndryshimit të pozicionit të punës, konsiderohet si i pranuar në heshtje. Lidhur me këtë fakt, Komisioneri vëren se shoqëria “Ujësjetllës Mat sh.a” me Vendimin nr.34, datë 16.08.2016, me të cilin i ka komunikuar ankuesit ndryshimin e pozicionit të punës nga K/Degës Ekonomike në Specialist Finance, i ka ndryshuar atij në thelb dy nga elementët thelbësore të kontratës së punës: pozicionin e punës dhe pagën. Ndryshimi i këtyre kushteve është bërë në mënyrë të njëanshme, pa pëlqimin me shkrim të ankuesit dhe për më tepër në dëm të tij.

Gjithashtu, shoqëria “Ujësjetllës Mat sh.a” nuk ka dërguar pranë Komisionerit dokumentacionin apo studimin që është kryer mbi ristrukturimin e shoqërisë dhe kriteret e përdorura për përzgjedhjen e punonjësve që do ndryshonin pozicionin e punës për shkak të ristrukturimit, në mënyrë që të provonte se emërimi në detyrën e specialistit të E.M është bërë për shkaqe të arsyeshme dhe jo për shkak të bindjes politike të E.M.

Lidhur me shkresën nr.751, datë 17.08.2016 të E.M, në të cilën kundërshton aktin nr.34, datë 16.08.2016 “Për lirim-emërim punonjësi” ku citohet në mënyrë të qartë se po diskriminohet nga ana e shoqërisë “Ujësjetllës Mat” sh.a, E.M, Komisioneri informon se, ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në nenin 15, pikat 1, 2, 3 dhe 4 parashikon se: *“1. Çdo punëmarrës ka të drejtë të ankohet te punëdhënësi, te Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ose në gjykatë, nëse beson se ka pësuar diskriminim. Kjo dispozitë nuk e kufizon të drejtën e ankimit në institucione të veçanta, të ngritura pranë sektorëve të ndryshëm të punësimit. 2. Gjatë periudhës së shqyrtimit të ankesës, punëmarrësi ka të drejtë të vazhdojë punën sipas kushteve të kontratës. 3. Punëmarrësi ka të drejtë të marrë informacion në çdo kohë në lidhje me trajtimin e ankesës, si dhe të marrë shpjegime për vendimet e marra nga punëdhënësi, në përgjigje të ankesës së tij, menjëherë pas shqyrtimit. 4. Në rast se punëdhënësi nuk merr masa për të hetuar dhe për të zgjidhur ankesën për diskriminim, punëmarrësi që ka bërë ankesën ka të drejtë ta ndërpresë punën, pa humbur të drejtën e pagës, për aq kohë sa është e nevojshme për t’u mbrojtur nga diskriminimi”*.

Në nenin 13, pika 1/c, të po këtij ligji, lidhur me detyrimet e punëdhënësit, parashikohet se: *“Punëdhënësi është i detyruar: c) t’u përgjigjet efektivisht dhe në përputhje me këtë ligj ankimeve të marra për shkak të diskriminimit të kryer nga punëmarrësit e tij, brenda një muaji nga marrja e tyre”*.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në nenin 5, pika 1, parashikon se: *“Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë”*.

Referuar zbatimit të nenit sipërcituar, Shoqëria “Ujësjetllës Mat” sh.a, nuk i është përgjigjur subjektit ankues në të dy rastet kur janë kërkuar shpjegime në lidhje me kundërshtimin e dhënies së masës disiplinore dhe në rastin e emërimit në detyrën e Specialistit të Financës, duke neglizhuar me dashje një të drejtë ligjore të tij dhe duke shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Për sa më lart, Komisioneri konstaton se shoqëria “Ujësjetllës Mat sh.a”, nuk ka përmbushur detyrimin ligjor të parashikuar në ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, duke mos dhënë shpjegime subjektit ankues mbi pretendimet e shprehura nga E.M.

## **II. Lidhur me shkakun e pretenduar nga ankuesi si shkak të sjelljes diskriminuese ndaj tij nga ana e shoqërisë “Ujësjetllës Mat sh.a”.**

Për të vërtetuar se ndaj subjektit ankues ka një sjellje diskriminuese nga ana e shoqërisë “Ujësjetllës Mat sh.a”, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”<sup>2</sup> dhe trajtimit të pafavorshëm të ankuesit.

Pretendimi i E.M se shkak për diskriminim ndaj tij janë bërë bindjet e tij politike, përbën një shkak që gëzon mbrojtje sipas nenit 1 të ligjit.

Nga shqyrtimi i dokumenteve nga Komisioneri, rezulton se E.M është anëtar i subjektit politik “Partia Socialiste e Shqipërisë” e vërtetuar me anë të kartës së anëtarësisë datë 26.04.2013 si dhe ka qenë anëtar i Qendrës së Votimit nr.0928 i propozuar nga subjekti politik “Partia Socialiste e Shqipërisë” gjatë zgjedhjeve vendore të datës 21.06.2015.

Komisioneri vlerëson se të gjitha pasojat negative në marrëdhënien e punësimit mes subjektit ankues dhe punëdhënësin A.L, kanë ardhur pas ndryshimit të administrimit të shoqërisë “Ujësjetllës Mat” sh.a nga P.S drejt pushtetit lokal dhe konkretisht drejt Bashkisë Mat e cila pas zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 21.06.2015 drejtohet nga një përfaqësues i subjektit politik “Partia Demokratike e Shqipërisë” dhe administratori i shoqërisë A.L është emëruar nga Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë Ujësjetllës Mat, N.R.

Shoqëria “Ujësjetllës Mat” sh.a pas kundërshtimit administrativ<sup>3</sup> të Vendimit nr.34, datë 16.08.2016, ka patur mundësinë e rishikimit të këtij vendimi ashtu siç bëri me të drejtë anulimin e aktit të emërimit të N.M ose ti kthente përgjigje ankuesit për pretendimet e tija, pasi ka patur një ndryshim të rëndësishëm në kushtet e kontratës individuale të punës në të cilën në nenin 2

<sup>2</sup> Në interpretim të nenin 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

<sup>3</sup> Me shkresën nr.751, datë 17.08.2016 të E.M drejtuar A.L ka kundërshtuar vendimin e emërimit me arsyetimin se paga e ofruar për vendin e specialistit të financës prej 30.000 lekësh ishte e ulët dhe diskriminuese krahasuar me të njëjtin pozicion pune në institucionet e tjera si në Rrethin e Matit ashtu dhe në Bashkinë Mat.

përcaktohet se: “Gjatë zbatimit të kontratës, punëdhënësi mund të transferojë punëmarrësin në vende të tjera apo në detyra të tjera brenda institucionit, duke njoftuar punëmarrësin”.

Referuar pretendimeve të ankuesit për trajtim të ndryshëm e diskriminues për shkak të gjendjes arsimore, Komisioneri vëren se:

- Ankuesi disponon Diplomën e Fakultetit Ekonomik, dega Financë-Kontabël, pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër.
- Nga shqyrtimi i akteve të depozituara nga shoqëria “Ujësjetllës Mat sh.a”, konkretisht në tabelat e strukturave dhe nivelit të pagave të shoqërisë “Ujësjetllës Mat sh.a” të vitit 2014 dhe të vitit 2016, për pozicionet K/Degës Ekonomike dhe Specialist Finance, është parashikuar, “Arsim i lartë” dhe përvoja e punës mbi 5 vjet.

Sa më sipër, pavarësisht pretendimeve të ankuesit për diskriminim për shkak të gjendjes arsimore, Komisioneri vlerëson se pretendimet e E.M janë të pabazuara, përse kohë që shoqëria “Ujësjetllës Mat sh.a” nuk ka ndryshuar nivelin e kualifikimit të kërkuar dhe për pasojë nuk përbën shkak për diskriminim.

### **III. Lidhja e shkakut me trajtimin e pafavorshëm.**

#### **III.1 Lidhur me faktin sa ka qenë ky trajtim objektiv dhe i arsyeshëm nga ana e shoqërisë “Ujësjetllës Mat sh.a”.**

Komisioneri gjykon se Shoqëria “Ujësjetllës Mat sh.a” nuk solli pranë Komisionerit asnjë provë apo fakt konkret, që të vërtetonin se trajtimi i E.M ishte objektiv dhe i arsyetuar.

Neni 82, pikat 2 dhe 3 e Kodit të Procedurës Administrative, lidhur me barrën e provës, parashikon se: “2. Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj. 3. Në mënyrë që të mbështesin pretendimet e tyre, palët mund t’i bashkëlidhin kërkesës për fillimin e procedurës administrative dokumente ose fakte të ndryshme”.

Referuar këtij parashikimi ligjor, Shoqëria “Ujësjetllës Mat sh.a” duhet të sillte prova dhe parashtrime që të provonin të kundërtën e pretendimeve të ankuesit. Mirëpo, gjatë komunikimit shkresor me zyrën e Komisionerit, Shoqëria “Ujësjetllës Mat sh.a” nuk ka arritur të argumentojë (kriteret e përdorura) se si ka arritur në përfundimin e caktimit të E.M në postin e specialistit dhe jo në pozicionin e shefit të sektorit apo të faktojë studimin mbi vendosjen e kategorive të pagave, por ka theksuar faktin se Shoqëria “Ujësjetllës Mat sh.a” nuk kanë patur dijeni për bindjet politike të E.M, duke qenë se një dokument i tillë nuk cilësohet në dosjen personale të punonjësve.

Nga parashtrimi i fakteve dhe shqyrtimi i dokumentacionit të sjellë pranë KMD-së, Komisioneri vlerëson se, ndryshimi pozicionit të punës nga K/Degës Ekonomike në Specialist është bërë i paargumentuar, në shkelje të ligjit dhe për më tepër tendencioz, duke e emëruar në një pozicion pune me një diferencë të madhe page.

Nisur nga shqyrtimi i këtyre fakteve, Komisioneri gjykon se, paligjshmëria e veprimeve apo mos veprimeve nga ana e Shoqërisë “Ujësjiellës Mat sh.a” në dëm të ankuesit, ka sjellë për pasojë edhe vendosjen e tij në kushte të disfavorshme, nga ana profesionale, duke e zbritur në detyrë dhe nga ana financiare duke e zbritur ndjeshëm në pagë.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në bazë të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, diskriminimi përkufizohet si: “çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

**Në këtë kontekst, referuar nenit 7, pika 1<sup>4</sup>, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, gjykojmë se E.M, është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe diskriminues, nga ana e Shoqërisë “Ujësjiellës Mat sh.a”, trajtim i cili ka lidhje me bindjet e tij politike.**

Neni 34, pika 1, e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcakton se: “ Çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim për një nga shkaqet e përmendura në nenin 1, të këtij ligji, mund të paraqesin kërkesëpadi përpara gjykatës kompetente, për dëmshpërblim sipas ligjit ose, sipas rastit, të kryejnë kallëzimi përpara organeve kompetente për ndjekje penale”. Në nenin 37, pika 1 e këtij ligji, parashikohet se: “Vendimi i Gjykatës cakton dëmshpërblim nëse gjykata vendos që ka shkelje të këtij ligji, duke përfshirë edhe një afat kohor për kryerjen e zhdëmtimit”.

<sup>4</sup> Në nenin 7, pika 1, të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikohet: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.



Komisioneri i rekomandon subjektin ankues që bazuar në sa më sipër citohet mund t'i drejtohet gjykatës për dëmshpërblim.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenet 1, 2, 3/1, 7/1, 12, 13 nenin 32, pika 1/a), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Konstatimin e diskriminimit të shtetasit E.M, nga ana e Shoqërisë “Ujësjetllës Mat sh.a”, për shkak të bindjes politike.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

**Irma BARAKU**

---

**KOMISIONERI**

(shkaku: bindja politike)  
(fusha: punësim)